

*buletini*info

Buletin informativ mujor
Janar, 2022



51.9%



Zyra e Kryeministrit



65.3%



Ministria e Punëve të Brendshme



67.8%



Ministria e Drejtësisë



54.1%



Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit



28.9%



Ministria e Mjekësisë dhe
Hapësirës dhe Infrastrukturës



87.7%



49.3%



Ministria e Tregëtisë, Ndermarresise
dhe Tregtisë



52.4%



Elbert Krasniqi

Ministri më i suksesshëm në Qeverinë e Republikës së Kosovës për vitin 2021



Reflektimi i ngritjes së
çmimeve te komuniteti



Familjet e pa strehë në
Gurrakoc të Istogut



Pozita e komuniteteve
në qeverisjen e majtë

Besimi për të drejtuar një Ministri nuk ishte vetëm kthim i borxhit

Lajm i mirë për komunitetin Egjiptas dhe për IRDK-në ishte vlerësimi nga FOL dhe PIPS i realizimit të planit të punës së Ministrive të Qeverisë së Kosovës, ku ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, që është përfaqësues i IRDK-së në Qeverinë e Kosovës, doli të jetë kampion në realizimin e punëve dhe detyrave të Ministrisë. Në asnjë Qeveri të Kosovës nuk kishte asnjëherë ministër nga radhët e komunitetit Egjiptas por as Rom apo Ashkali, edhe pse drejtimi i Ministrive nga komunitetet jo shumicë është precizuar në Kushtetutën e Kosovës. Vetëm qëndrimi dinjitoz i IRDK-së në mandatin e kaluar duke i qëndruar besnik parimeve bëri që Kryeministri Albin Kurti të tregohet i vendosur dhe t'ia besoj Elbert Krasniqit drejtimin e një ministrie shumë të rëndësishme siç është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Vendimi i kryeministrit Albin Kurti doli të jetë edhe i drejt. Kryeministri Albin Kurti, gjatë mandatit të kaluar, kur institucionet e Kosovës u sfiduan shumë, shumë shpejt e kuptoj ndryshimin e IRDK-së nga partitë tjera të komuniteteve jo shumicë. Ai e vlerësoj mënyrën e artikullimit të vizionit nga ana e drejtuesve të IRDK-së, dhe i'u besua drejtimi i ministrisë. Shkathtësitë dhe puna me përgjegjësi i ministrit Elbert Krasniqi, duke u vlerësuar me 100% të realizimit të planit, është mënyra më e mirë për të çmuar besimin e Kryeministrit Albin Kurti. Duke qenë kampion në udhëheqje brenda Qeverisë, po thyhen paragjykimet e shoqërisë së Kosovës për komunitetin Egjiptas. Komuniteti Egjiptas gjithmonë ka pas personalitete të shquara por që rrallë herë janë identifikuar si pjesëtar të komunitetit. Në vetët '80 kishte sportist nga klubi i boksit të Prishtinës ku njeri nga ata ishte edhe nënkampion botëror në kategorinë që kishte boksuar. Edhe në të kaluarën dhe sot ka këngëtar të mirëfilltë të muzikës popullore që janë emra të dalluar në trevat shqiptare. Kishte edhe gazetar që punuan për medime të njohura botërore në seksionin e gjuhës shqipe. Ka pas edhe luftëtar të UÇK-së të cilët luftuan për lirinë e Kosovës. Kemi edhe mjek shumë të shquar në Perëndim që shumë

shpesh, për shkak të ekspertizës, i gjejmë edhe në Kosovë. Tani kemi edhe politikan të cilët me punë dhe ndershmëri shkëlqejnë në institucionet e Kosovës. Diskutimet e deputetit të IRDK-së në Parlamentin e Kosovës janë shumë përmbajtësore dhe shpërfaqin një kulturë politike që mund t'i u shërbejë edhe kolegeve të tij deputet.

Të gjithë personalitet publike dhe profesionistë janë shumë të rëndësishëm edhe për imazhin e komunitetit që nuk është edhe aq i mirë. Është e qartë se kur realizohen statistika që kanë bazë etninë, atëherë rangohemi me varfërinë më të madhe. Gjithashtu edhe diskriminimi, racizmi dhe dukuritë tjera që e kanë bazën te paragjykimet, janë të pranishme dhe të pa pranueshme. Këto dukuri duhet të ndalen nga shoqëria e Kosovës duke u nxitur nga klasa politike dhe shoqëria civile që përfaqësojnë komunitetin.

Aq sa është e rëndësishme të paraqitet në opinion ana e errët, si varfëria, diskriminimi, etj. shumë e rëndësishme është edhe promovimi i vlerave të komunitetit përmes personaliteteve. Për të luftuar të keqen nevojitet aktivizëm qytetar të komunitetit duke këmbëngulur ndryshimin e gjendjes. Me pasivitet e viktimizim nuk mund të dilet nga gjendja e rëndë. Pa përballim të konkurrencës, komuniteti nuk hynë në fazën e zhvillimit dhe nuk arrihet barazia. Përballimi i konkurrencës na bënë të barabartë, të rëndësishëm dhe të respektueshëm. Të tregosh profesionalizëm në mjekësi, inxhinieri, gazetari, polici, ushtari, mësimdhënie, sport e kulturë atëherë je i krahasueshëm me të tjerët dhe mund të jesh edhe i barabartë. Aktivizmi jonë për të qenë konkurrent në shoqëri, duhet të jetë kauzë e ditëve tona. Guximi për t'u përballë me sfidat e jetës ka qenë i pranishëm gjithmonë. Bile guximi për përballje me të përditshmen është edhe në kulturën tonë, që jo rrallë na bënë edhe të dalluar, si rasti i Elbert Krasniqit në udhëheqjen me përgjegjësi të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Fazli Stollaj



Ministri Elbert Krasniq më i suksesshmi në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Lëvizja FOL ka bërë monitorimin e Planit Vjetor të Punës për periudhën mars-dhjetor 2021 të 15 Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit. Nga 764 aktivitete të parapara për këtë periudhë kohore, janë realizuar 428 aktivitete, dhe 336 nuk janë realizuar.

Zyra e Kryeministrit - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 77 aktivitete prej të cilave ka realizuar 40 nga këto aktivitete.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 71 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 35 nga këto aktivitete.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 76 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 22 nga këto aktivitete.

Ministria e Drejtësisë - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 59 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 40 nga këto aktivitete.

Ministria e Zhvillimit Rajonal - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 35 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 33 nga këto aktivitete.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 37 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 20 nga këto aktivitete.

Ministria e Ekonomisë - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 27 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 14 nga këto aktivitete.

Ministria e Mbrojtjes - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 57 aktivitete, prej të cilave i ka realizuar 50 nga këto aktivitete.

Ministria e Punëve të Brendshme - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 98 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 64 nga këto aktivitete.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 42 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 22 nga këto aktivitete.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 11 aktivitete, prej të cilave ka realizuar të gjitha aktivitetet.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 52 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 19 nga këto aktivitete.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 31 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 21 nga këto aktivitete.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 37 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 12 nga këto aktivitete.

Ministria e Shëndetësisë - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 43 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 20 nga këto aktivitete.

Ministria për Kthim dhe Komunitete - në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për periudhën mars-dhjetor 2021, ka paraparë të realizoj 11 aktivitete, prej të cilave ka realizuar 5 nga këto aktivitete.



Fjala e deputetit të IRDK-së, Fridon Lala, në Parlamentin e Kosovës, lidhur me reflektimin e ngritjes së çmimeve te komuniteti Egjiptian

Si përfaqësues i komunitetit Egjiptian të Kosovës, njërit prej grupeve më të varfëra që jeton në vend, me duhet të përcjell shqetësimet e tyre serioze për sa i përket rritjes së çmimeve të produkteve bazë, e së fundmi edhe propozimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

Egjiptianët janë njëri prej grupeve më të varfura që jetojnë në Kosovë, fakt që pasqyrohet nga raporte të institucioneve kredibile ndërkombëtare, mirëpo edhe nga të dhënat e institucioneve tona vendore. Sipas të dhënave të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil, Egjiptianët janë grupi etnik me numrin më të ulët të të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës. Raporti i Komisionit Evropian për vitin e kaluar tregon që shkalla e papunësisë te ky komunitet është mbi 90%, e pjesa dërmuese e atyre pak personave që punojnë janë të angazhuar në ekonomi jo-formale, të paregjistruar e gëzojnë shumë pak të drejta. Raportet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, tregojnë që në sektorin privat ky komunitet paguhet më pak se të tjerët. E mesatarja e të ardhurave ditore për familjet që jetojnë në varfëri të skajshme të këtij komunitetit është rreth 60 cent, sipas të dhënave të Banës Botërore dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Është matematikë e thjeshtë për të kuptuar që për një familje të varfër Egjiptiane e cila mbijeton me rreth 60 cent në ditë, kjo rritje e çmimeve është enorme edhe e papërbalueshme. Sidomos kur shohim se rritje më të lartë kanë pësuar produktet bazë të shportës së konsumatorit si buka, drithërat, mishi, qumështi, djathi, vaji, vezët, pemët dhe perimet. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çmimet e produkteve të konsumit janë rritur për 5.7 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2021. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë, në një mesatare prej 6.7 për qind në muajin dhjetor 2021, krahasuar me muajin dhjetor 2020.

Kjo reflektohet në ngritjen e çmimeve të konsumit në produktet bazë: bukë dhe drithëra (14.4%); mish (6.2%); qumësht, djathë dhe vezë (6.8%); vajra dhe yndyra ushqimore (32.7%); perime (11.5%). E nëse ngritjes së çmimeve ja shtojmë dhe propozimin e shtrenjtimit të rrymës elektrike, jeta e qytetarëve egjiptianë në Kosovë do të rëndohet tej mase, në fakt, do të jetë absolutisht e pamundur për ta për ti bërë ballë inflacionit të rritur. Si do të jenë në gjendje ata ti paguajnë faturat e rritura në qoftë se i marrim parasysh shifrat të cilat I përmenda më herët rreth varfërisë dhe papunësisë?

E kuptoj logjikën që konsumi tejkalon kapacitetet prodhuese, rryma duhet te importohet nga jashtë, dhe çmimet në tregjet botërore janë rritur tej mase, mirëpo qytetarët nuk e kanë fajin e shitjes së pari e at her mungesës së mbikëqyrjes institucionale të korporatës së energjisë e cila ndër vite ka dështuar të investojë e të rrisë kapacitetet prodhuese, derisa rrymën e prodhuar e merr me njërin prej çmimeve më të lira në Europë. Po, duhet të kursehet energji, mirëpo për shumë familje të varfëra të cilat në pamundësi për të siguruar drunjë si lëndë djegëse, kanë vendosur të ngrohen me rrymë, e tani do të jetë e pamundur për ta të rikthehen në ngrohje me drunjë ku edhe çmimi i drunjëve sipas agjencisë së statistikave është rritur për 4,6%.

Normalisht, e mirëpresim vendimin e qeverisë për të subvencionuar një pjesë të qytetarëve në pagesën shtesë së rrymës. Në vendimin e qeverisë numër 20/50 përmenden disa kategori sociale e pensionmarrëse që do të subvencionohen. Është mirë të kemi sqarime shtesë si do të subvencionohen këto kategori e në këtë rast dhe si do të përfitojnë ato familje të komunitetit Egjiptian që janë pjesë e skemës sociale.

E kuptoj dhe logjikën prapa shtrenjtimit të çmimeve, kryesisht në produkte të importuara nga shtetet e rajonit dhe Evropës, të cilat janë shtrenjtuar në botë për arsye të shtrenjtimit të çmimeve globale të rrymës, mungesës së gazit, rritjes së stokeve si pasojë e pandemisë etj.. Mirëpo ekziston prapë hapësirë që qeveria të ndikojë në mënyrë që të lehtësojë shportën e konsumatorit në Kosovë.

Ndërhyrja në tregun e lirë është e vështirë mirëpo vende në rajon I janë përgjigjur rritjes së inflacionit në mënyra të ndryshme si psh duke ngrirë çmimet e produkteve bazike. Këto kriza na tregojnë dhe rëndësinë që të stimulojmë prodhimtarinë dhe ta orientojmë ekonominë më shumë drejtë prodhimit me ç'rast importet për produktet bazë do të ulëshin e kostoja e produkteve vendore do të ishte më e përballueshme për qytetarët në të ardhmen.



Fjala e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me rastin e shënimit të 24 Qershorit

24 Qershor 2021,

Të nderuar ministra të kabinetit qeverisës, z. Elbert Krasniqi dhe z. Hajrulla Çeku,
Të nderuar deputetë të Kuvendit, znj. Mimoza Kusari Lila dhe z. Fridon Lala,
I nderuar drejtor, z. Habit Hajredini,
E nderuar znj. Diana Shaka, përfaqësuese nga shoqëria civile,

Mirë se po e gjejmë njëri-tjetrin në këtë Konferencë të rëndësishme në një ditë të posaçme.

Kam kënaqësinë e veçantë që t'ua uroj të gjithëve 24 Qershorin, Ditën Memoriale të Komunitetit Egjiptian në Republikën e Kosovës dhe kudo që ata jetojnë.

Komuniteti Egjiptian ndër vite jeton në këto troje dhe së bashku me popullsinë shumicë ndau fatin e mirë e të keq edhe për shkak të afërsisë kulturore e gjuhësore. Vetëm gjatë viteve '90, edhe nxënësit e komunitetit egjiptian ishin përzënë nga shkollat, shumë punëtorë ishin përjashtuar nga puna për shkak të solidarizimit në grevat e organizuara nga sindikatat, ndërsa gjatë viteve të luftës, '98-'99, kishin viktimë civile, por edhe pjesëtarë të UÇK-së që luftuan për çlirimin e Kosovës.

Organizimi politik i komunitetit Egjiptian gjatë këtyre dy dekadave, ishte kontributdhënës për shtetësinë e Kosovës dhe pa dyshim se komuniteti si në të kaluarën edhe sot për Kosovën, kultivon dashurinë për atdheun e tyre.

Sot komuniteti egjiptian është pjesë e barabartë dhe vlerë e shtuar e shoqërisë kosovare. Prandaj, promovimi, mbrojtja, ofrimi i mundësive të barabarta dhe i trajtimit të barabartë për të gjithë, pa diskriminim, është me rëndësi të veçantë për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Edhe pse ka pasur zhvillime pozitive në aspektin e mbrojtjes, promovimit dhe zbatimit të të drejtave të komuniteteve në shumë fusha, jemi të vetëdijshëm se ka ende sfida të shumta dhe gjendja e komuniteteve, edhe atij egjiptian nuk është e mirë, si nga aspekti i diskriminimit edhe ai socio-ekonomik. Si rezultat i papunësisë së këtij komuniteti varfëria është prezente, ende kemi nevojë që ky komunitet të përfshihet në arsimim, e sidomos në arsimin e lartë dhe atë profesional.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë përkushtimin e saj për të përmirësuar kushtet socio-ekonomike përmes gjithëpërfshirjes dhe avancimit të të drejtave të komunitetit egjiptian. Ne jemi krenarë që sot e kemi ministrin e Pushtetit Lokal të Qeverisë tonë nga radhët e këtij komuniteti, një aktivist politik i vyeshëm e i ndershëm, i cili u përcaktua palëkundshëm për ndryshime edhe në opozitë.

Ne synojmë që ta zbatojmë në plotni Ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë, me të cilin përcaktohet që në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve.

Do të punojmë në përmbushjen e premtimeve të vendosura në Programin e Qeverisë, ku prioritetet në kuadër të Qëllimeve Strategjike dhe Objektivave Operacionale të Zyrës së Kryeministrit është përfshirë edhe përmirësimi dhe avancimin i gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes zbatimit dhe monitorimit të këtyre politikave. Me qëllim të arritjes së këtij prioriteti, kemi paraparë një mekanizëm për nxitjen, promovimin dhe bashkërendimin institucional të punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet publike.

Gjithashtu për avancimin e përgjithshëm të situatës, tani jemi në fazën e parë për të zhvilluar strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke u bazuar në kornizën e re strategjike të BE-së për përfshirjen e komuniteteve 2020-2030.

Qeverisja e mirë, sundimi i ligjit dhe barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit mbetet qëllimi dhe synimi jonë kryesor. Një nga objektivat më të rëndësishme të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbetet hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit që përmirësojnë dhe përmbushin të drejtat dhe shërbimet e qytetarëve në vend, sidomos me fokus në grupet më të marginalizuara të shoqërisë, duke përfshirë edhe qytetarët e komunitetit egjiptian.

Ndërgjegjësimi institucional është pikënisja, shteti duhet të veprojë, e krahas kësaj edhe puna e përbashkët me qytetarët. T'i ndjekim shembujt e mirë të bashkëpunimit, dhe të veprojme aktivisht për përmirësimin e mirëqenies të të gjithë qytetarëve tanë, pa dallim.

Urime 24 Qershori e ju faleminderit.



Familjet e pastrehë në Gurrakoc të Istogut

Burgu i Gurrakocit në komunën e Istogut është ndërtuar në vitin 1950. Ky burg njihet për trajtim të ashpër të te burgosurve. Pas përfundimit të luftës me 1999 burgu i Gurrakocit pushoi së funksionuari. Familje të ndryshme që nuk kishin ku të banoni, rreth vitit 2002 u vendosen në ndërtesën e burgut, edhe pse kjo ndërtesë nuk i plotësonte kushtet. Për një periudhë tri katër vjeçare komuna e Istogut e menaxhoi ndërtesën si strehimore duke iu siguruar ndihma ushqimore e higjienike familjeve të vendosura në këtë ndërtesë dhe në fund përmes programeve të përbashkëta me organizatat ndërkombëtare në Kosovë u financua ndërtimi i shtëpive për familjet e strehimores. Me ndërtimin e shtëpive përfundoi edhe menaxhimi i strehimores nga ana e komunës së Istogut.

Familje të pastrehë, edhe pse ndërtesa e burgut nuk i plotësonte kushtet për banim, diku prej vitit 2011, u vendosen dhe ndërtesa vazhdoi të jetë e populluar prej rreth familjeve që vinin nga komuna e Istogut, Klinës, Skenderajt dhe Malishevës.

Në fund të vitit 2020, komuna e Istogut vendosi që të rrënoj ndërtesën e burgut të Gurrakocit me arsyetimin se rrezikohen seriozisht familjet që banojnë në atë ndërtesë. Në këtë kohë jetonin tetë familje të komuniteteve dhe komunave të ndryshme. Nga komuna e Istogut të strehuar kanë qenë: Kadri Çitaku, Kamber Kikaj, Florentina Mehmeti, Blerina Tafaj, Shefkije Halitaj, Remzie Tafaj. Nga komuna e Klinës vazhdojnë edhe tani të qëndrojnë Florim Brakaj dhe Armend Singh.

Me angazhimin e deputetit të atëhershëm Elbert Krasniqi, me kryetarin e komunës së Istogut Haki Rugova u pajtuan që komuna e Istogut të paguaj qiranë për familjet që janë nga komuna e Istogut. Me kryetarin e komunës së Klinës, deputeti Elbert Krasniqi nuk arriti të bëjë asnjë zgjidhje për dy familjet që vinë nga komuna e Klinës pasi që kryetari Zenun Elezaj ofroj mundësinë e një pagese si subvencion dhe nuk është dakorduar që të zbatoj praktikën e komunës së Istogut për pagesë të qirasë.

Vendimi për rrënimin e ndërtesës së Burgut të Gurakocit nuk është ekzekutuar. Ndërtesa qëndron aty ku është ndërtuar para 70 viteve dhe në këtë ndërtesë, në kushte ekstremisht të këqija vazhdojnë të qëndrojnë kohë pas kohe Florim Brakaj dhe Armend Singh.

Kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, ka vendosur që të vazhdoj pagesën e qirasë për gjashtë familje e komunës së Istogut dhe ka shprehur interesim për zgjidhje të qëndrueshme të banimit për këto familje.



Florim Brakaj ende është banor i burgut të Gurakocit. Ai është 53 vjeç dhe jeton i vetëm. Florimi ka lindur në Ujmirë të Klinës. Para se të vijë në Gurakoc ai ka jetuar në Budisalc të Klinës. Nuk ka pronë të tij dhe nuk ka gjetur mbështetje në komunën e tij. Shpresa e tij është në komunën e Istogut sepse ai jetoj prej vitit 2013 në këtë komunë. Ai thotë se çfarëdo zgjidhje

që bëhet për banorët e tjerë të ish burgut të më përfshijë edhe mua.

Armend Singh i cili jeton me një vajzë të moshës së vogël e ndjen veten të lënë anash pasi që banorët tjerë janë strehuar përkohësisht. As Armendi nuk ka gjetë mbështetje në komunën e Klinës sa i përket strehimit.

Zgjidhja e problemit të banimit për tetë familjet që kanë jetuar në ndërtesën e ish burgut të Gurakocit është e vështirë për t'u zgjidhur. Të gjithë këto familje deklarojnë se nuk kanë pronë të tyre ku mund të financohej ndërtimi i shtëpive për banim. Komuna e Istogut ka pranuar që të merret vetëm me familjet që janë të komunës së Istogut, ndërsa komuna e Klinës nuk është aspak e brengosur që disa qytetarë të kësaj komune jetojnë në kushte të rënda.

Ministria e Kulturës do të dihej që të merrej me ruajtjen e burgut si monument i së kaluarës së hidhur për ata që kanë kaluar ditë të vështira sa funksiononte si burg dhe në bashkëpunim me komunën e Istogut dhe komunën e Klinës, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë zgjidhje për banorët e burgut të Gurakocit të cilët po bëhen pjesë e historisë së hidhur të këtij burgu. Kushtet e familjeve që zgjedhën të jenë banorë të burgut të Gurakocit na japin një fotografi të dhimbshme për të qartësuar se si jeton një pjesë e shoqërisë së Kosovës.



Mbështetja për Kuzhinat popullore në situatën e pandemisë

Shoqata humanitare “Vëllezërit e diasporës”, e udhëhequr nga Fadil Dukagjini, është njëra prej shoqatave e cila është mbështetur nga Qeveria e Kosovës në kuadër të Masës 3.4 Mbështetja për Kuzhinat Popullore/Humanitare. Kjo shoqatë ka filluar zbatimin e projektit me datën 26 Nëntor të vitit 2021 dhe projekti do të zgjasë një vit. Ky projekt i Qeverisë së Kosovës i cili zbatohet në kuadër të masave për zbutjen e pasojave të pandemisë, synon mbështetje me ushqime për skamnore. Shoqata humanitare “Vëllezërit e diasporës”, e zbaton këtë projekt në komunën e Istogut dhe komunën e Klinës. Nga drejtuesi i shoqatës “Vëllezërit e diasporës”, z.Fadil Dukagjini jemi informuar

se një herë në javë familjet të cilat plotësojnë kriteret furnizohen me gjëra ushqimore.

Në komunën e Istogut, një herë në javë furnizohen me gjëra ushqimore 124 familje me gjithsej 646 anëtarë dhe në komunën e Klinës përfituese janë 98 familje me 547 anëtarë. Përfituese nga ky projekt janë familjet që janë raste sociale, familjet që nuk kanë të punësuar apo që kanë një të punësuar por që nuk arrijnë të plotësojnë nevojat elementare. Vetëm gjendja sociale është kriter për të qenë përfitues në këtë projekt, prandaj nga projekti po ndihmohen familjet e të gjitha komuniteteve që paraqiten te shoqata dhe i plotësojnë kriteret e përcaktuara

MENY JAVORE NR.2	
1.VOJ-----	160 - LITRA
2. SUPA-----	300 - COPA
3.DOMATE-----	20 - PAKO
4.QEP-----	150 - MREZHA
5.BIBER TE KUQ-----	160 - COPA
6.KOS 1 KG-----	160 - COPA
7.PASUL-----	160 - COPA
8.VEZE-----	50 - TABLLA
9.BUK-----	250 - COPA
10.Kosa te vogel-----	80-COPA

MENY JAVORE NR 1	
1.LAKRA-----	400 KG----- + SHQER =180 KG----- +MAJ BUKE =180 COPA
2.DJATH-----	4 KANTA 20KG----- +ORIZ.160 COPA----- +KRYP =160 KG
3.SPECA-----	160 KG----- + BUKE =250 COPA--MAKARONA=160

MENY - JAVORE.NR .3	
1.QUMSHT-----	200 - LITRA
2.DJATH NE KILOGRAM-----	20 - KG 4 KANTA
3.PATATE-----	160 - MREZHA
4.MAKARONA -----	160 - COPA
5.VIGETA-----	160-COPA
6.SHMAND 400 GR----	80 COPA---- + 80----COPA.800 GR
7. BUKE =250 COPA	

MENYJA NR4	
1.VOJ-----	160 - LITRA
2. SUPA-----	300 - COPA
3.DOMATE-----	20 - PAKO
4.QEP-----	150 - MREZHA
5.BIBER TE KUQ-----	160 - COPA
6.VEZE-----	100 - TABLLA
7.PASUL-----	160 - COPA
8.ORIZ-----	160 - KG
9.BUK-----	250 -COPA
10.JUGURT-----	1.LITER-DRENA-OSE-VITA=160. COPA

Lista e artikujve ushqimor e përpiluar nga Shoqata humanitare "Vëllezërit e diasporës"

Në komunën e Istogut përfitojnë familjet nga shumë lokacione.

Nga Istogu 7 familje, nga Cerrca 9 familje, Dragolevci i Ulët 8 familje, Dubrava 6 familje, Muzhevina 3 familje, Dragolevci i Epërmë 5 familje, Kovraga 6 familje, Veriqi 6 familje, Serbobrani 31 familje, Gurrakoci 7 familje, Zallqi 14 familje, Dreja 5 familje, Banja 8 familje, Dobrusha 4 familje, Prekalla 1 familje, Saradrani 3 familje dhe Koshi 1 familje.

Në komunën e Klinës përfitues të projektit janë: Klnavc 26 familje, Klinë 4 familje, Shtupel 15 familje, Budisalc 5 familje, Sferkë 1 familje, Jellovc 1 familje, Grabanicë 1 familje, Qupevë 2 familje, Dugujevë 2 familje, Gllarevë 1 familje, Poterq 2 familje, Perqevë 1 familje, Volljak 3 familje, Mahalla në Klinë 11 familje, Jagodë 8 familje, Jashanicë 5 familje, Gjurgjevik 1 familje, Vedejë 2 familje, Rudicë 4 familje, Krusheva e Madhe 2 familje dhe Stupë 1 familje.

Nga projekti për Mbështetje të Kuzhinave popullore/humanitare përfituesit furnizohen një herë në javë me artikuj ushqimor si: bukë, qumësht, djathë, patate, lakra, specia, makarona, shmand, vegetë, supë, vaj, domate, qep, vezë, pasul, oriz, etj.

Në situatën jo të mirë që po e kalojnë familjet skamnore, nga Masa 3.4 e Qeverisë së Kosovës për mbështetje të kuzhinave popullore, deri në nëntor të vitit 2022, në komunën e Istogut dhe komunën e Klinës do të përfitojnë rreth 220 familje me rreth 1200 anëtarë. Masa 3.4 është duke u zbatuar edhe në komuna tjera të Kosovës.

Pozita e komuniteteve në qeverisjen e majtë



Jeton Rrahmani

Masat e njerëzve tradicionalisht janë ndarë në klasa, në këtë këndvështrim pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian rëndom kanë qenë të ranguar si proletariat. Përfashtim bënë një numër i vogël fisesh e familjesh që mund të kenë qenë klasë e mesme apo edhe klasë e lartë kapitaliste. Hapat e ndërmarrë për të pësuar progres i orientoi masat proletare në mejdanin politik në të cilën arma e vetme që e ke në duar për të fituar betejën është të mos shmangesh nga ideologjia parësore dhe linja e argumentimit që e posedon. Momentum paqësorë që aspironte populli jonë ndër vite për barazi sociale dhe realizimin e të drejtave dhe lirive themelore duhej që të implementoheshin në rrugë institucionale. Themelimi i shtëpisë së parë politike IRDK ishte një ndër hapat e parë dhe më të rëndësishëm për jetësimin e këtyre vlerave. Pika 1.2 e statutit si akti më i lartë i kësaj partie tregon qartë që IRDK është parti e qendrës me orientim socialdemokrat. Veprimtaria e saj është e përqendruar në mirëqenien sociale, ekonomike, arsimore, kulturore të qytetareve të Kosovës dhe në veçanti promovimin e identitetit etnik, vlerave kulturore e historike dhe avancimin e pozitës së egjiptianeve të Kosovës. Gjithashtu programi politik i IRDK-së ka qenë i përqendruar në edukim, punësim, infrastrukturë e mirëqenie sociale. Madje edhe slogani i zgjedhjeve të 14 Shkurtit ishte Barazi dhe Dinjitet. Barazia dhe Dinjiteti ishin përcaktuar nga lartë poshtë si parim i politik bërjes ngase barazia që sot e gëzojmë duke qenë të përfaqësuar në institucionet më të larta të vendit me punë e

përkushtim do të sjellë edhe barazinë sociale që momentalisht është e brishtë. Barazia institucionale do të ishte vakante nëse nuk do të ishte e mbështjellur me petkun e dinjitetit. Kurti-Krasniqi të dy këta me bindje socialdemokrate kanë krijuar binomin që është faktori kyç për përmirësimin e statusit shoqërorë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa publikimi i realizimit të planit të punës së Qeverisë për vitin 2021 nga FOL dhe PIPS, Elbert Krasniqi rezulton si ministri më i suksesshëm i Qeverisë Kurti në realizimin e aktiviteteve duke i realizuar për 100% ato. Përderisa në të kaluarën kemi pasur lider politik që sa herë i u është përmendur emri në portale të ndryshme kanë qenë shkas aferat korruptive, pasuria e pa paramendueshme, vjedhja dhe keqpërdorimi i mijëra eurove. Ky është një argument i fortë që dëshmon se po udhëhiqemi dinjitetshëm nga liderët tonë politik. IRDK për vetëm 10 muaj sa është pjesë e Qeverisë ka arritur të realizojë zotimet e saj të dhëna në fushatë elektorale nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejtë pjesëtarët e komuniteteve anë e kënd vendit por edhe qytetarë të tjerë pa dallime etnike. Madje nga puna e mirë e IRDK-së për mirëqenien e qytetarit po përfitojnë në mënyrë direkte edhe persona me bindje të kundërta politike. 42.000.000€ në tri vitet e ardhshme për programin e banimit të qëndrueshëm nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. 250.000€ për rregullimin e stacionit transfer në Ali Ibra (Gjakovë) nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. 300.000€ për rregullimin e ujësjellësit në Fushë Kosovë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. 1.000.000€ projekte infrastrukturore nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 1.500.000 për nevoja të komuniteteve nga Zyra e Kryeministrit. 600.000€ nga Ministria e Financave për iniciativa të tjera. Këto janë disa nga projektet që janë realizuar e disa do të realizohen në të ardhmen e afërt. Pikëpamja dhe programi politik i partive në pushtet kryesisht derivojnë nga orientimi ideologjik i majtë që ka në fokus shtresën e ulët të varfër, pra sot kemi një Qeveri sociale gjithëpërfshirëse dhe me të drejtë quhet Qeveria e popullit ngase intervenon më shumë aty ku nevojat janë më të mëdha. Prandaj nuk është e rastësishme kjo mbështetje gjithëpopullore sepse aleat i Qeverisë është qytetari të cilin Qeveria e sheh si qenie njerëzore e jo vetëm si një numër në kutitë e votimit.



Prof Skënder Rizaj (1930 - 2021)

Profesor Skender Rizaj dha kontribut të çmueshëm me shkrime shkencore dhe paraqitje të tij lidhur me Egjiptianët. Profesor Skender Rizaj vdiç me 28 Nëntor 2021. Për të kujtuar profesorin Rizaj po e botojmë kumtesën e tij në Konferencës shkencore të mbajtur në Prishtinë, në vitin 2003.

Në tri vitet e fundit dolën në skenë politike, shoqërore dhe kulturore emrat: egjiptian, ashkalinj dhe rom. Këta emra po përdoren pa kuptim të përkufizuar kombëtar, etnik dhe bashkiak. U formuan edhe partitë politike të këtyre pakicave etnike. Përveç kësaj, me këto tri emra në zgjedhjet e fundit parlamentare (2001) u zgjodhën deputetet të parlamentit të Kosovës edhe përfaqësuesit e tyre. Megjithëkëtë, jo vetëm gjatë fushatës parazgjedhore dhe në emisionet speciale televizive, por edhe në Parlamentin e Kosovës, paraqitjet e udhëheqësve – deputeteve të këtyre kategorive pakicash etnike ishin konfuze, kontradiktore dhe ndonjëherë edhe absurde. Më këtë rast mbase do të përjashtonim paraqitjen e zotëri Bislim Hoti, kryetar i partisë “Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (egjiptiane) dhe deputet në Parlamentin e Kosovës, i cili në një emision të RTK, kishte dalë me një qëndrim mjaft konstruktiv sa i përket kësaj çështjeje. Sipas këtij personaliteti: “Udhëheqësit e ashkalinjeve dhe të romëve numrin e pakicave të tyre e kanë fryrë aq shumë sa që, gjykuar sipas të tillëve, po na del se kinse Kosova paska 4 milion banorë. Në këtë mënyrë shqiptaret po na dalin pakicë kombëtare.” Sinonimi ashkali, për emrin egjiptian është emërtim lokal, i cili përdoret vetëm në rrafshin e Kosovës.

Ndërkaq, në rrafshin e Dukagjinit përdoret sinonimi tjetër – magjup. Këto sinonime (shkali dhe magjup) nga shqiptarët përdoret me kuptim përbuzës. Egjiptianët e Shqipërisë Etnike (Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia) janë me prejardhje nga Egjipti. Gjuha e këtyre është shqipja prandaj quhen egjiptian shqiptar.

Më saktë, siç quhen në popull, magjup-shqiptar, apo ashkalinj-shqiptar. Nga ana tjetër, romet janë me prejardhje nga India dhe gjuha e tyre është rome. Lidhur me historinë e magjupeve (egjiptianeve) dhe romëve deri me sot ka studime nga studiues të ndryshëm. Madje, edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë e dëshmon prejardhjen e këtyre dy etnitetëve: të magjupeve (egjiptianeve) nga Egjipti dhe të romeve nga India. Sipas enciklopedive botërore, rom, arinj ose cigan janë sinonime. Cigan-i m.sh. –ë, –ët. Pjesëtar i një popullsie me prejardhje nga India dhe që jeton zakonisht në mënyrë endacake a gjysmendacake në Evropë, në disa vende të Azisë dhe të Afrikës. Gjuha cigane. Këngë (valle) cigane. Jeta cigane. Nga ana tjetër, magjupet, evgjit, më saktë egjiptianet, sipas rezultateve nga hulumtimet e studiuesve përendimor janë me prejardhje jo nga India, por nga Egjipti.

Në të mirë të këtij konstatimi dëshmojnë këto të dhëna historike: Pellazget, stërgjyshërit e shqiptareve, djepi i të cilëve ishte Gadishulli Ballkanik, gjatë mijëvjeçarëve IV-I p.e.s., për shkak të shtimit të madh të tyre u detyruan të përhapeshin në anë të ndryshme të botës – në drejtim të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës, me ç'rast e krijojnë perandorinë e tyre shumë të madhe – Perandorinë Pellazgjike. Kështu një grup i konsiderueshëm pellazgësh të vendit Palesta (në Himarë – Shqipëri Jugore), para 3.200 vjetëve shpërngulen nga Palesta për në ishullin Kreta. Më pastaj, nga Kreta dynden për në Azi të Vigël ku e krijojnë shtetin e tyre me emrin Palestina: Palestina=Ana e palesheve (në pellazgjishte - shqipe). Këtu duhet të shtojmë faktin se pellazgjishtja – shqipja ishte gjuhë universale dhe popullore e komunikimit në këtë pjesë të botës. Këtë fakt dhe fenomen historik e dëshmojnë me argumente relevante një seri studiuesish – pellazgolog të huaj dhe shqiptarë. Kështu, sipas Robert d'Angely-t: “Nga koha e Jezu Krishtit, për shembull, e vetmja gjuhë zotëruese që është folur në të gjitha perandoritë romake (në Evropë, në Azi dhe në Afrikë), ka qenë shqipja, dhe fryma e saj nuk do ta kishte një fakt të tillë që ta luante atë rol të rëndësishëm, të cilin ka mundur ta luante. Latinishtja dhe greqishtja nuk kanë qenë, ashtu si sanskritishtja, veçse gjuhë letrare dhe ditore.

Lidhur me këtë ja se çfarë ka shkruar A. S. Sayce (në “Principes de Philologie comparee”, parathënia e botimit të parë, Paris, 1884, f. XIII). ‘ sanskritishtja është qenësisht një gjuhë diturie, që kurrë nuk është folur, ashtu siç na e tregojnë dokumentet. Ajo u shërben sot priftërinjve dhe letrareve. Ajo është shfronësuar nga vendi i lartë që zinte si përfaqësuese e veçantë e gjuhës mëmë ariane (pellazgjike – shqipe), dhe është pranuar se nga disa pikëpamje gjuhët evropiane kanë ruajtur me besnikëri tingujt e formës primitive, sesa i kanë gjuhët e Indisë. ‘ ne po e citojmë këtë pjesë vetëm sepse ajo konfirmon nga të gjitha anët mendimin tonë po për këtë çështje, domethënë se ka qenë gjuha pellazge ose shqipe ajo që duke u nisur nga 3.000 vjet para Krishtit ka sjellë lindjen e gjuhës primitive të Indisë dhe, vetëkuptohet, gjithashtu të sanskritishtes...”.

Madje edhe Librat e Shenjta të zbritura profetëve, që nga profeti Adem e deri të profeti Muhamed, kanë qenë të shkruara në gjuhën që e dinte dhe kuptonte populli, pra në pellazgjishte hyjnore, më saktë në gjuhën shqipe. Lidhur më këtë fenomen opsioni shqiptar ka pasur mundësi të njoftohet përmes veprave të dijetarit të shquar arbresh Giuseppe Catapano: “Thot – Tat për lava albanese “ dhe “ Antichita della Lingua albanese (... anche Cristo parlo questi idioma)”.

Tani po kthehemi sërisht te problemi i egjiptianëve – shqiptar. Këtu, pra, një numër pellazgë të Egjiptit, të cilët për arsye deri më sot të panjohura, janë shtrënguar të dynden në Siujdhesën Ballkanike, kanë ardhur këtu me gjuhën e tyre amtare pellazgjike – shqipe – egjiptiane.

Këta të shpërngulur, në të vertetë, kanë kaluar nga një trevë e Pellazgjisë në trevën tjetër të saj – në djepin e pellazgëve – në Gadishullin Ballkanik.

Për këtë arsye, këta muhaxhirë janë quajtur, sipas atdheut të tyre të lashtë – magjupë ose gjupë, gjipë. Fjala ma-gjup, ma-gjip ka dalë nga emri E-gjup, E-gjypt, E-gjipt. Mirëpo, emri magjup, me kohë, në mjedise tona ka marrë kuptim përbuzës, prandaj nuk do të ishte gabim nëse ky emër zëvendësohet me emrin egjiptian në pikëpamje etnike, kurse me emrin shqiptar në pikëpamje kombëtare.

Për më tepër, egjiptianët – shqiptarë, shqipen e kanë gjuhë amtare dhe kombëtare, ndërsa Shqipërinë Etnike (Kosovën, Maqedoninë, Shqipërinë, ...) e kanë territor kombëtar dhe shtetëror. Atëherë pra, egjiptianët në këtë mjedis na pikëpamje kombëtare duhet të jenë shqiptarë, sepse kombi egjiptian nuk ekziston askund në botë, pra as në Egjipt. Edhe egjiptianët në Egjipt në pikëpamje kombëtare janë arab e jo egjiptian sepse gjuha dhe kultura e tyre është arabishtja. Emiri ashkali, duhet të hiqet krejtësisht nga përdorimi, sepse nuk e tregon as përkatësinë kombëtare as përkatësinë etnike, madje as përkatësinë territoriale. Më një fjalë, ky emër nuk ka kurrfarë kuptimi domethënës. Emri shkali ka dalë nga fjala shqipe: ashk/ël, -la, f.sh. -la, lat, copë e vogël dhe e hollë që shpëputet nga druri, kur e qajnë e presin me sëpatë. Pra shkali do të thotë: njeri që copëton dru me sëpatë; druvar. Kumtesën time do ta përfundoj me dy ajete kur'anore dhe një hadith të profetit Muhamed. “[O Profeti im, thotë Xhebraili:] Zoti (Rabbi) yt [All-llahu Krijues] u ka thënë engjëjve: 'Unë gjithsesi do të mëshiroj – trupëzoj (tin) NJË NJERI [profetin Adem nga qenia ime]. Posa do të kompletojë këtë [trupin e profetit Muhamed] do t'ia japë shpirtin [Ruh-i a'zam = shpirti absolut], shpirt ky i cili do të jëtë rreze e Shpirtit tim [Ruh-i ilaçi ose Ruh-i lika]. Prandaj, atij ju [engjëj] menjëherë përruljuni (bini në sexhde)’” (Kur'an: 38/71, 72). Këtë fenomen Profeti universal dhe unik, Muhamedi a.s., e shpjegon në këtë mënyrë: “Bëj be se të gjithë njerëzit janë vëllezër. As arapi, as axhemi (persiani) përka origjina, nuk kanë përparësi njeri ndaj tjetrit të gjithë janë pasardhës të hz. Ademit.

Të gjithë jeni prej Ademit, kurse ai është prej 'tinit' (qenies së Zotit). Për këtë arsye, mos u lavdëroni me arabizëm dhe axhemizëm. Kjo nuk është për lavdërim. Prandaj lartësoni veten te Zoti (Rabbi) me vepra të mira dhe evitoni veprat e këqija!”. Me fjalë tjera All-llah xh.sh të gjitha krijesat tjera të kozmosit, pra edhe Tokën me krijesat e saj, i ka krijuar për hir të profetit dhe pasardhësve të tij – njerëzve, me kusht që këto të mos i keqpërdorin njerëzit paskrupull, përkundrazi të tillët do të ndëshkohen rreptë nga Krijuesi i tyre.

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: buletini.info@gmail.com